

Statistikat e Krimeve

Tremujori I 2017


Tiranë, më 15 qershor 2017: Në tremujorin e parë 2017 janë kryer 7.495 vepra penale, rreth 3,5 % më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Gjatë tremujorit të parë 2017 janë regjistruar 7.829 autorë të veprave penale të cilët janë 4,8 % më pak krahasuar me tremujorin e parë 2016.

Ndaj totalit të veprave penale, pjesën më të madhe e zënë “Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike”, me 39,4 %, “Krimet kundër autoritetit të shtetit” me 35,8 % dhe “Krimet kundër personit” me 20,3 %.

Tab. 1 Veprat penale dhe autorët

Grupveprat penale	T1 - 2016		T1 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
Krime kundër njerëzimit	0	0	0	0
Vepra penale kundër personit	1.484	1.728	1.522	1.846
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	3.277	3.127	2.956	2.689
Vepra penale kundër mjedisit	54	57	64	63
Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues	1	11	1	1
Krime që çënojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera	0	0	0	0
Aktet terroriste	1	0	3	3
Krime kundër autoritetit të shtetit	2.613	2.950	2.683	2.907
Vepra penale kundër drejtësisë	58	67	52	56
Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve	0	0	0	0
Vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale	277	286	214	264
Gjithsej	7.765	8.226	7.495	7.829

Fig.1 Veprat penale dhe autorët




Për publikim 15/06/2017

Vepra penale kundër personit

Gjatë tremujorit të parë 2017 janë kryer 1.522 vepra penale kundër personit, me një rritje prej 2,6 % në krahasim me tremujorin e parë 2016. Numri i autorëve të krimeve kundër personit, në këtë periudhë është 1.846, dhe përbën 23,6 % të totalit. Gjatë tremujorit të parë 2017, numri i autorëve të kësaj vepre penale ka shënuar rritje me 6,8 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Fig. 2 Veprat penale dhe autorët kundër personit



Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Në tremujorin e parë 2017 janë kryer 2.956 vepra penale “*Krimet kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*”, duke pësuar ulje me 9,8 % krahasuar me tremujorin e parë 2016. Autorët e tyre janë 2.689, rreth 14 % më pak se në të njëjtën tremujor të një viti më parë dhe përbëjnë 34,3 % të totalit. Në këto vepra penale, vjedhjet zënë 46,4 % të totalit. Krahasuar me tremujorin e parë 2016, gjatë këtij tremujori vjedhjet kanë pësuar një ulje me 20,7 %.

Fig.3 Veprat penale dhe autorët kundër pasurisë dhe sferës ekonomike




Veprat penale kundër autoritetit të shtetit

Në tremujorin e parë 2017 janë kryer 2.683 vepra penale, me një rritje prej 2,7 % në krahasim me tremujorin e parë 2016. Numri i autorëve gjatë tremujorit të parë 2017, është 2.907, duke shënuar një ulje me 1,4 % në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, përbëjnë përqindjen më të madhe të veprave kundër autoritetit të shtetit, me rreth 76 %, duke regjistruar një ulje të lehtë prej 2,9 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Fig.4 Veprat penale kundër autoritetit të shtetit



Masat e sigurisë

Gjatë tremujorit të parë 2017, numërohen 7.829 masa sigurie për autorë të veprave penale, nga 8.226 që ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë duke pësuar një ulje me 4,8 %.

Fig.5 Masat e sigurisë të ndërmarra për autorët e veprave penale



Tab. 2 Veprat penale kundër personit

Vepra penale kundër personit	T1 - 2016		T 1 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
Krime kundër jetës	335	360	330	360
<i>Vrasje</i>	20	14	8	6
<i>Vrasje nga pakujdesia</i>	0	0	0	0
<i>Vrasje mbetur tentativë</i>	33	36	33	38
<i>Kanosje serioze për hakmarrje ose gjakmarrje</i>	0	0	1	1
<i>Kanosja</i>	282	310	288	315
Kundër shëndetit	300	416	299	418
<i>Plagosje e lehtë me dashje</i>	270	372	268	383
<i>Mjekim pakujdesshëm</i>	1	3	2	2
<i>Të tjera</i>	29	41	29	33
Krime seksuale	16	16	29	30
<i>Tentativë mardhënie seksuale</i>	1	1	2	2
<i>Të tjera</i>	15	15	27	28
Vepra penale kundër lirisë së personit	24	24	21	33
<i>Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie e pasurisë</i>	3	1	7	16
<i>Trafikimi i personave</i>	17	18	14	17
<i>Të tjera</i>	4	5	0	0
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	32	80	49	84
<i>Ushtrim prostitucioni</i>	9	46	10	34
<i>Shfrytëzim prostitucioni</i>	19	29	30	40
<i>Mbajtja e lokaleve për prostitucion</i>	4	5	9	10
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	382	404	382	400
<i>Trafikimi i të miturit</i>	4	5	5	5
<i>Dhuna në familje (neni130/a)</i>	329	348	345	362
<i>Të tjera kundër familjes</i>	49	51	32	33
Vepra penale kundër lirisë së besimit	0	0	0	0
Të tjera kundër personit	395	428	412	521
Gjithsej	1.484	1.728	1.522	1.846

Tab. 3 Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike

Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	T1 - 2016		T1 - 2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
Vjedhje pasurie	1.729	1.478	1.371	1.070
<i>Vjedhje banese</i>	310	186	300	159
<i>Vjedhje kompanie firme</i>	9	8	12	5
<i>Vjedhje lokale tregtie</i>	164	112	146	114
<i>Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën</i>	19	21	30	33
<i>Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike</i>	513	519	203	210
<i>Vjedhja me dhunë</i>	33	44	49	65
<i>Trafikimi i mjeteve motorike</i>	37	35	38	35
<i>Tentativë vjedhje</i>	123	107	107	85
<i>Të tjera Vjedhje</i>	521	446	486	364
Mashtrimet	169	199	242	259
<i>Mashtrimi</i>	124	149	197	212
<i>Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit</i>	2	3	3	3
<i>Shkelja e të drejtave të pronësisë industriale</i>	43	47	42	44
Shkatërrimi i pronës	334	320	281	247
<i>Shkatërrimi i pronës me zjarr</i>	47	20	57	19
<i>Shkatërrimi i pronës me eksploziv</i>	11	1	12	2
<i>Shkatërrimi i pronës me mjete të tjera</i>	276	299	212	226
Krime në fushën e doganave	79	86	54	57
Veprat në lidhje me tatimet dhe taksat	128	135	245	250
Në fushën e fallsifikimeve	234	255	275	287
Vepra penale që çënojnë regjimin juridik	320	367	244	254
<i>Ndërtimi i paligjshëm</i>	320	367	244	254
Të tjera ekonomike-finaciare	284	287	244	265
Gjithsej	3.277	3.127	2.956	2.689

Tab. 4 Veprat penale kundër autoritetit të shtetit

Krime kundër autoritetit të shtetit	T1-2016		T1-2017	
	Vepra të evidentuara	Autorë	Vepra të evidentuara	Autorë
Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasit	521	727	538	657
<i>Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik</i>	119	167	96	108
<i>Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik</i>	191	241	158	198
<i>Në fushën e korrupsionit</i>	211	319	284	351
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike	1.985	2.110	2.042	2.135
<i>Trafikimi i armëve dhe i municionit</i>	12	15	6	3
<i>Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive</i>	5	5	2	3
<i>Prodhimi dhe shitja e narkotikëve</i>	312	395	379	481
<i>Trafikimi i narkotikëve</i>	18	20	63	70
<i>Kultivimi i bimëve narkotike</i>	9	8	6	27
<i>Të tjera në fushën e drogës</i>	10	13	10	13
<i>Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale</i>	87	107	92	112
<i>Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor</i>	459	432	406	391
<i>Drejtimi i automjeteve në gjendje të dehur apo pa dëshmi</i>	620	621	566	571
<i>Largimi nga vendi i aksidentit</i>	93	51	101	52
<i>Vepra në fushën e teknologjisë</i>	52	18	59	15
<i>Të tjera kundër rendit dhe sigurisë</i>	308	425	352	397
Vepra penale kundër sekretit dhe kufijëve shtetëror	107	113	103	115
<i>Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror</i>	95	99	92	99
<i>Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve</i>	12	14	11	16
Gjithsej	2.613	2.950	2.683	2.907

Tab. 5 Masat e sigurisë të ndërmarra për autorët e veprave penale

	Masat e sigurisë	
	T 1 2016	T 2 2017
Arrestuar	2.652	2.090
Ndalar	539	368
Gjykim i lirë	4.407	4.729
Larguar	615	621
Të ndryshme	13	21
Gjithsej	8.226	7.829

Metodologjia

Statistikat e krimeve pasqyrojnë të dhëna mbi veprat penale të evidentuara dhe personat e dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Grupimi i veprave penale është bërë sipas ndarjes referuar Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, respektivisht në 11 kapituj dhe duke u ndalur në seksionet e çdo kapitulli, ku janë evidentuar vepra penale gjatë tremujorit të parë të vitit 2017 dhe 2016.

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara i referohen artikujve të Kodit Penal dhe jo ngjarjes, pasi në një ngjarje mund të gjejmë më shumë se një element kriminal të veprës penale.

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, jo në gjykime të cilat janë në kompetencat e organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin. Të dhënat mbi autorët gjithashtu përfshijnë edhe të dhëna mbi masat e sigurimit.

Përkufizime:

Vepra penale: Veprat me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

Vepra penale kundër personit: Përfshihen veprat penale kundër jetës, shëndetit, lirisë, moralit dhe dinjitetit, veprat penale kundër familjes, martesës, fëmijëve dhe kundër lirisë së besimit.

Veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike përfshijnë vepra të tilla si: Vjedhjet e pasurisë, mashtrimet, krime në fushën e doganave dhe tatim-taksave, vepra që cënojnë regjimin juridik.

Veprat penale kundër autoritetit të shtetit përfshijnë vepra të tilla si: kundër veprimtarisë shtetërore nga shtetasi, kundër rendit dhe sigurisë publike si dhe kundër sekretit dhe kufijëve shtetëror, ku secili seksion përmban në vetvete një sërë aktesh të tjera.

Autorë: Persona të cilët me veprimin ose mosveprimin e tyre lejon që të ndodh një vepër penale pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale.

Vepra të raportuara: vepra të raportuara në polici ose që policia ka njohuri mbi to në mënyra të tjera.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit

Të dhënat mbi veprat penale të evidentuara dhe autorët janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.